

Drejtuar:
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
Shkup

LËNDA: Iniciativë për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit

Avokati i Popullit, në përputhje me autorizimet nga neni 30, paragrafi 1 i Ligjit për Avokatin e Popullit ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 60/03 dhe 114/09) pranë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, si propozues i autorizuar, **paraqet Iniciativë** për hartimin e propozimit për ndryshimin dhe plotësimin e dispozitave të Ligjit për procedurë tatimore dhe Ligjit për tatimet mbi pronën.

Përkatësisht, Avokati i Popullit duke vepruar në kuadër të autorizimeve për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve, në punën e tij me lëndë konstatoi se në procedurën për arkëtim të detyrueshëm të borxhit tatimor nga llogaria në bankë, e cila i përket personit fizik, zgjidhjet ekzistuese normative shkaktajnë probleme dhe pasiguri juridike sepse nuk mbahet llogari për dinjitetin e debitorëve dhe familjeve të tyre, si dhe për atë që përmbarimi të jetë më i favorshëm për debitorin.

Konkretisht, në këto procedura dhe në përputhje me aktvendimet për arkëtim të detyrueshëm mbi kërkesat në llogarinë bankare, të miratuara nga Drejtoria e të Ardhurave Publike, Qyteti i Shkupit dhe komunat, bankat afariste, nga personat fizikë e marrin tërë shumën e parave, të cilën ata e pranojnë në emër të pagës, pensionit, mbrojtjes sociale dhe ngjashëm, përkatësisht nuk zbatohen dispozitat për përjashtim-kufizim nga arkëtimi i detyrueshëm, të parashikuara në nenin 130 të Ligjit për procedurë tatimore dhe nenin 57 të Ligjit për tatimet mbi pronën.

Së këtëjmi, në pjesën më të madhe të rasteve, për personat fizikë shuma e parave mbi këtë bazë në llogaritë e transaksionit janë të ardhurat e vetme, të cilat ata i marrin, ndërsa si rezultat i mënyrës së këtillë të përmbarimit ata lihen pa kurrfarë të ardhurash me çka rrezikohet edhe ekzistenca e tyre.

Drejtoria e të Ardhurave Publike, Qyteti i Shkupit dhe komunat, përveç tjerash, e informojnë Avokatin e Popullit se në momentin kur e miratojnë aktvendimin për arkëtim të detyrueshëm mbi kërkesën sipas llogarisë në bankë, nuk kanë informata për ekzistimin e vlerësimit të bazave ligjore për kufizimin e përmbarimit, përkatësisht se dispozitat e tilla duhet t'i zbatojnë vetëm kur bëjnë arkëtim me vendosjen e ndalimit mbi të ardhurat personale tek punëdhënësi ose Fondi i SPIM.

Për Avokatin e Popullit nuk është aspak kontestuese se organi, në asnjë rast, nuk mund ta zbatojë përmbarimin në dëm të debitorit, duke e zbatuar përmbarimin mbi pagën e plotë të tij, pensionin dhe të ardhurat mbi bazë të sigurimit social, kuptohet

nëse për personin fizik këto janë të ardhura të vetme në llogarinë e transaksionit mbi bazë të pagës, pensionit ose të ardhurave mbi bazë të sigurimit social.

Tërheqja e shumës së përgjithshme në para, të cilën në emër të pensionit, pagës, ndihmës sociale dhe ngjashëm, personi fizik e merr në llogarinë e tij të transaksionit dhe lënia e tij pa mjete themelore për ekzistencë, paraqet shkelje të të drejtave të tij, shkaktim i paarsyeshëm të dëmit, mosrespektim të dispozitave ligjore dhe veprim jashtë parimeve të proklamuar kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve.

Pikërisht për këtë, Avokati i Popullit konsideron se për tejkalimin e gjendjes së këtyllë dhe respektimin konsekuent të kufizimeve ligjore, gjatë zbatimit të aktvendimit për përmbarrim nga llogaria e transaksionit e debitorit-person fizik, nevojitet ndryshim dhe plotësim adekuat i Ligjit për procedurë tatimore dhe Ligjit për tatimet mbi pronën, në mënyrë që do të precizohet mënyra e përmbarrimit kur bëhet fjalë për përmbarrim mbi kërkesa në para për llogarinë në bankë, e cila i takon debitorit-personit fizik.

Në fakt, është e nevojshme të parashikohen dispozita, konform të cilave Drejtoria e të Ardhurave Publike, Qyteti i Shkupit dhe komunat, aktvendimet për arkëtim të detyrueshëm mbi kërkesën në para sipas llogarisë në bankë, e cila i takon personit fizik, detyrimisht t'i përpilojnë duke i respektuar kufizimet e përmbarrimit të nenit 130 të Ligjit për procedurë tatimore dhe nenit 57 të Ligjit për tatimet mbi pronën, gjatë zbatimit të përmbarrimit të mbahet llogari për dinjitetin e debitorëve dhe familjeve të tyre, si dhe për atë që përmbarrimi të jetë më i favorshëm për debitorin.

Së këtejmi, me zgjidhjen e këtyllë normative gjithsesi se do të arrihet siguri më e madhe juridike në përmbarrimin e urdhrave nga llogaritë e transaksionit të debitorit-personit fizik, përkatësisht debitori do të ketë mundësi t'i realizojë të drejtat e tij ligjore të kufizimit gjatë përmbarrimit nga paga dhe baza të tjera. Drejtoria e të Ardhurave Publike, Qyteti i Shkupit dhe komunat në mënyrë efikase t'i mbulojnë kërkesat e tyre, ndërsa bankat të sigurojnë përmbarrim efikas të pagesës, me këtë rast pa i rrezikuar të drejtat e depozituesve të tyre.

Së fundmi, për masat dhe veprimet e ndërmarra nga ana Juaj, nevojitet ta njoftoni Avokatin e Popullit.

Z.B.

AVOKAT I POPULLIT
Ixhet Memeti